

NE I JAPIM NGJYRË



BOTËS

VLERA E VOTËS SONË

RIGON (10), MEDINA (10), EDONIS (10), RINESA (10), ERION (10), EGZONA (10)



Pjesëmarrja e qytetarëve në zgjedhje, është shumë e rëndësishme në demokraci

Jemi mësuar që çdo ditë të shkojmë në shkollë dhe me shumë pak ndryshime nga dita në ditë, ta kalojmë një ditë rutinore.

Sot, po ndodh diçka më ndryshe prej ditëve të tjera. Kemi ardhur këtu në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“, ku kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme, kemi bërë vizatime të llojllojshme dhe kemi folur për demokracinë. Më pas jemi ndarë në grupe dhe secili prej grupeve ka diskutuar për një temë të caktuar.


Në grupin tonë, kemi diskutuar për zgjedhjet që ne i bëjmë në shtëpitë tona, në shkollë, kur jemi me shoqëri, etj. Nëse nëna do më kishte pyetur mua se a dëshiroj të ha shpageta apo picë, unë do të zgjedhja picën, sepse ajo është çka unë dua të zgjedh.

Zgjedhjet që ne i bëjmë, na bëjnë shumë të lumtur, për arsye se ne i bëjmë ato sipas preferencave tona.

Kur ne jemi më të përgatitur për jetë, domethënë pas moshës 18 vjeçare, ne do të kemi mundësi të marrim pjesë në zgjedhje.

Ne do të mund të marrim pjesë në zgjedhjet lokale, ku do ta zgjedhim kryetarin/en e komunës sonë, por edhe në zgjedhjet qendrore, ku do të votojmë për deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Sipas nesh, një përfaqësues/e ideal/e do të ishte ai/ ajo i/e cila e mban fjalën, është modest/e dhe ai/ajo i/e cili/a bën vepra të mira. Prandaj ne duhet të mendojemi mirë para se t'i zgjedhim përfaqësuesit tanë.



Ne e vendosim se cilën alternativë ta zgjedhim

Ne i gëzojemi faktit që jemi pjesë e një shteti demokratik, siç është Kosova. Por, ne edhe duhet të kontribuojmë në ndërtimin e këtij shteti.

Andaj, të gjithë ne duhet të marrim pjesë në zgjedhje dhe së bashku ta bëjmë ndryshimin.




Ne e përfaqësojmë Kuvendin si gazetarë të përgjegjshëm

Ne jemi nxënës nga dy klasët e V-ta nga komuna e Vitisë, dhe sot kemi pasur rastin të jemi gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Është një privilegj i madh të kemi një rol të tillë, prandaj e kemi mbajtur me shumë përgjegjësi këtë rol. Ne jemi përpjekur ta bëjmë një gazetë të mbushur me shumë informata rreth temave që lidhen me demokracinë. Më poshtë, mund ti shihni edhe disa nga vizatimet e punuara nga vetë ne



Qytetarët aktiv, marrin iniciativa të ndryshme për të bërë ndryshime në shtet. Këtë, ata e bëjnë me vullnetin e tyre




Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme në një shtet demokratik, sepse qytetarët marrin vendime duke votuar



Lumturia është një gjë shumë e rëndësishme. Atë mund ta arrijmë vetëm nëse jetojmë në një shtet demokratik



Ne si qytetarë të Kosovës kemi një mori të drejtash. Një gjë e tillë ndodh pasi që Kosova është shtet demokratik



Në demokraci, të gjithë jemi të barabartë pa dallim feje, race, gjinie, moshe, apo ndonjë dallimi tjetër



Një ambient i pastër, nuk nevojitet vetëm për t'u dukur bukur qyteti. Pastërtia ndikon edhe në shëndetin tonë

NE KEMI TË DREJTA TË MBROJTURA ME LIGJ

BLERON (10), EDION (10), MUHARREM (10), BEQIR (10), LAURETA (11), LEONA (9)



Të gjithë fëmijët në botë kanë të drejta të barabarta të cilat mbrohen me ligj. Se cilat janë disa nga të drejtat tona do ta mësoni në artikullin tonë të shkruar me shumë dashuri për ju

Të dashur lexues, siç edhe ju e dini, fëmijë janë të gjithë personat nën moshën 18 vjeçare. Sipas nesh, e ardhmja e shtetit janë fëmijët, të cilët gëzojnë shumë të drejta dhe përgjegjësi. Të drejtat edhe përgjegjësitë që ne i kemi, i diskutuam edhe në grupin tonë të vogël. Ne, së bashku në grup u munduam të bëjmë krahasime se si trajtoheshin fëmijët më herët dhe se si trajtohen fëmijët tash. Krahasimi në këtë pikë ishte mjaft mbresëlënës, sepse aq shumë respektohen fëmijët sot, sa që më përpara nuk e kishin këtë respekt. Kjo dëshmohej nga fakti se zhvillimi i vazhdueshëm i sistemit demokratik të qeverisjes ka ndikuar që edhe më shumë ti ofrohet përkrahje dhe mbështetje të drejtave të fëmijëve. Pikërisht për këtë arsye, Kuvendi si institucion ligjvënës ka miratuar disa ligje për të drejtat e fëmijëve. Këto ligje janë në funksion për të gjithë ne. Edhe Kryetari i tanishëm i Kuvendit të Kosovës ka deklaruar se: „Të drejtat e fëmijëve janë të drejtat më të rëndësishme në vendin tonë“. Kjo nënkupton se fëmijët janë baza e një shteti demokratik. Këtë nuk e kemi pasur rastin ta mësojmë vetëm në teori, por ne e kemi parë edhe në praktikë se si të drejtat tona mbrohen dhe respektohen. P.sh., duke u nisur nga shkolla jonë, kemi parë se trajtohem në mënyrë të barabartë,



Përgjegjësia jonë është që të mësojmë


dhe të gjithë pa asnjë dallim kemi qasje në institucionet shkollore. E kjo lidhet me të drejtën e shkollim që e gëzojmë ne. Ne, po ashtu jemi dëshmitar të shumë të drejtave të tjera që i kemi, prandaj mundohemi që të jemi të përgjegjshëm për veprimet tona. Afër të drejtave ne e dijmë se janë edhe përgjegjësitë që na takojnë. Prandaj, ju ftojme të gjithëve të jeni mirënjohës ndaj të drejtave tuaja dhe mos harroni të kontribuoni për Kosovën.



Ne kemi të drejtë të shprehemi lirshëm

VEPRIMET E QYTETARËVE AKTIV

LABINOT (10), BLEND (10), YLLKA (10), JEHONA (10), ELONA (10), RUBINA (10)



Ne jemi gazetarët e „Demos-ti“ dhe do të flasim për të drejtat e qytetarëve aktiv, për përgjegjësitë e tyre dhe për veprimet që ata duhet ti bëjnë për shtetin e tyre të dashur

Qytetar është çdo person që jeton brenda një shteti të caktuar. Mirëpo, edhe refugjatët nga vende të ndryshme, të cilët kanë ardhur të jetojnë p.sh. në Kosovë, pas një kohe mund të bëhen qytetarë të Republikës së Kosovës. Por, ata duhet t'i rregullojnë disa dokumente për t'u regjistruar kështu si qytetarë të këtij vendi. Në vendin tonë, edhe në shumë vende të tjera ka të drejta të shumta. Gjithashtu ka edhe përgjegjësi të ndryshme përkundrejt të drejtave. Po fillojmë të numërojmë disa nga të drejtat që kemi ne si qytetarë të këtij vendi. Ne kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e punës, të drejtat e fëmijëve, të drejtën për familje dhe të drejtën për të votuar në moshën e duhur, nga mosha nga 18 vjeç. Po ashtu, ne kemi përgjegjësi, të cilat janë: respektimi i ligjeve, respektimi i të drejtave të qytetarëve, respektimi i rregullave të komunikacionit, etj. Ne kemi përgjegjësi edhe në familje, që do të thotë se ne duhet

të kujdesemi për familjen tonë dhe të iu mundësojmë të gjithëve t'i shprehin mendimet e veta lirshëm. Kurse, tek e drejta për të zgjedhur, qytetarët kanë përgjegjësi të votojnë kandidatët më të mirë për deputetë. Pastaj, deputetët e zgjedhur votojnë Kryeministrin dhe Presidentin e vendit. Nëse qytetarët nuk do të kishin të drejtën për të votuar, atëherë ne nuk do të kishim deputetë, Kryeministër e ministra, dhe kështu nuk do ti kishim as ligjet ekzistuese. Prandaj, e tërë përgjegjësia iu bie mbi supë qytetarëve në ndërtimin e shtetit. Qytetarët të cilët janë aktiv, nëse nuk janë të kënaqur duhet të ngrisin zërin dhe të nënshkruajnë peticione e të protestojnë në mënyrë paqësore. Ne sot jemi ulur në tavolinë dhe kemi menduar për të gjitha çështjet që janë problematike në fshatin tonë. Nga Punëtorja sot, jemi frymëzuar që të formulojmë një shembull të një peticioni. Në atë peticion shënuam kërkesat tona për gjërat që na nevojiten neve dhe rrethit tonë. Të gjithë anëtarët e grupit tonë nënshkruam peticionin dhe e dijme se atë duhet ta dërgojmë në Komunën tonë. Ne jemi dhe do të vazhdojmë të jemi qytetarë aktiv.





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Skender Emërlahu“
Klasa: V-1 & V-2
Vendi: Ramjan & Fshati i Ri, Viti